



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 639/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik KDTP me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it A nr. 428/2010 të datës 13.12.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik KDTP, për rishqyrtimin e vendimit të PZAP-t, Anr. 428/2010 të datës 13.12.2010.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 15.12.2010, nga subjekti politik KDTP, në të cilën pretendohet se “PZAP-i me vendimin A nr. 428/2010 të datës 13.12.2010, ka refuzuar në mënyr të njëanshme ankesën e subjektit politik KDTP në lidhje me mbulimin e posterave të kandidatës të KDTP-se me nr 40 nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetevendosje (LVV). Parashtruesi i apelit thekson se në këtë vendim arsyeja e refuzimit të ankesës është gabimi i datës të shkruar nga ana e anëtarëve të subjektit politik KDTP, pa marre parasysh se fotot dëshmojnë se ka pasur shkelje dhe nuk ka rëndësi gabimi i datës”. Sipas parashtruesit të apelit është e vërtet që data rezulton si 10.12.2010 por ky është thjesht një gabim ose leshim shkrimi, për arsye se ankesa në është dërguar me datën 11.12.2010 dhe ky fakt është reflektuar në përgjigjen në ankesë të LVV-se për mbulimin e posterave të kandidatës së KDTP-se e cila i është dhënë nga PZAP-i partise tone me daten 10.12.2010.

Vendim i PZAP-it Anr. 428 të datës 13.12.2010, është marrë në bazë të dispozitave ligjore të nenit 118 paragrafi 1 i LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 6 pika (d) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, që parashohin se:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

neni 3.6 (d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur më vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Neni 118 paragrafi 4 i LZP-së parasheh:

118.4 Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.

PZAP pasi shqyrtoj shkresat e lendes arsyetoj si me poshtë:

-refuzohet si i pabazuar apeli

PZAP thekson se arsyeja për të cilën ankesa me numër A 428 dt, 11.12.2010 është refuzuar, nuk konsiston thjesht në një gabim teknik nga ana e parashtruesit KDTP. Me rëndësi është fakti se shkeljet e pretenduara në A428 ka qene të pabazuara dhe kontradiktore me dëshmitë e ofruara si dhe në mospërputhje me atë çka është nënshkruar prej parashtruesit të ankesës. Nga shkresat e lëndës ka rezultuar se KDTP e ka nënshkruar ankesën përpara se ngjarja e supozuar të kishte ndodhur. Gjithashtu pretendimet nga parashtruesi i apelit, se vendimi A nr. 428 është i pabazuar, i njëanshëm si dhe pretendimi se data e nënshkrimit është thjesht një gabim teknik, nuk është bindës dhe nuk ofron asnjë fakt të ri që do të ndikonte në ndryshimin e këtij vendimi. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 639/2010 më datën 23.12.2010.

